AUTOKRACIA NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË: NGJASHMËRI SI DY PIKA UJI

Fragment nga intervista e dhënë për gazetaren Denisa Pasholli në A2 CNN

AUTOKRACIA NË SHQIPËRI DHE NË KOSOVË:

NGJASHMËRI SI DY PIKA UJI

Fragment nga intervista e dhënë për gazetaren Denisa Pasholli në A2 CNN

Duhet të ndalem në një pikë.

Edhe në Kosovë, edhe në Shqipëri po vihet re një fenomen. Proceset demokratike, si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri, kanë pasur oshilacionet dhe vështirësitë e veta.

Në Shqipëri kemi pasur zgjedhje të ndershme dhe të pandershme, por kemi ardhur në një pikë kur të gjithë i kemi pranuar zgjedhjet e vitit 2013 si zgjedhje të ndershme. Po kështu ka ndodhur edhe

në Kosovë. Me gjithë kontradiktat dhe kundërthëniet, kemi arritur në një proces zgjedhor të lirë dhe të ndershëm (*free and fair*). Kosovarët, deri tani, kanë marrë vazhdimisht komplimente për mënyrën se si i organizojnë dhe i zhvillojnë zgjedhjet.

Vjen një moment kur një lider e merr pushtetin me vota të lira, të ndershme dhe të njohura. Por, në qoftë se ky lider ka vendosur që në fillim të jetës së tij politike se, sapo të vijë në pushtet, nuk do ta lëshojë më atë, atëherë ai nuk e lëshon derisa dikush ta nxjerrë nga zyra.

Në qoftë se pushteti merret me votën e lirë dhe më pas personalizohet e kapitalizohet; në qoftë se të gjitha instancat e shtetit bëhen pronë e një

njeriu apo e një partie; në qoftë se, përveç ekzekutivit, futen duart te drejtësia, te biznesi, te media, te shërbimet informative, te patronazhimi dhe kudo tjetër ku ushtrohet ndikimi shtetëror, atëherë pushteti nuk lëshohet më.

Dhe ky pushtet nuk mund të merret më lehtë nga një masë e lirë zgjedhësish, kur ai që është në pushtet punëson me mijëra njerëz, të cilët nuk punojnë për shtetin, por për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e pushtetit partiak.

Unë mendoj se, meqenëse jemi një komb, një popull, flasim një gjuhë dhe kemi një gjak, i ngjajmë shumë njëri-tjetrit. Për këtë arsye, fenomenet politike që shfaqen në

njërin shtet shqiptar, herët a vonë, priren të shfaqen edhe në tjetrin.